



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

VENDIM

Nr. 470, datë 31.07.2024

PËR

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...},
PËR NË FORMIMIN FILLESTAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS,
PËR MAGJISTRAT, PROFILI GJYQËTAR, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 31.07.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar, për magistrat (profili gjyqtar), në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatës znj. {...}”, për vitin akademik 2023-2024, relatuar nga z. Ilir Rusi,

VËREN:

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Znj. {...} është candidate për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili gjyqtar, në kushtet kur:

a) është vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës, në bazë të Raportit të Vlerësimit Përfundimtar të datës 17.05.2023, se plotëson kriteret e pranimit në formimin fillestar për magistrat sipas nenit 28 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin);

b) ka marrë pjesë në provimin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës sipas nenit 31 të Ligjit të Statusit dhe është përfshirë në listën e renditjes së kandidatëve fitues në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkresën nr.374/4 prot., datë 31.05.2023 (protokolluar në Këshill me aktin nr. 2944/2 prot., datë 01.06.2023).

2. Me Vendimin nr. 375, datë 13.07.2023, mbështetur në nenin 32 të Ligjit për Statusin, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur *fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të*

kandidimit për në formimin fillestar për magistratë, profili gjyqtar, në Shkollën e Magistraturës, për vitin akademik 2023-2024, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat, ku në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...} si relator u caktua z. Alban Toro.

3. Më datë 13.07.2023, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatja, znj. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidatja u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

4. Brenda afatit treditör, kandidatja, znj. {...} depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidatja nuk parashtrori ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Më datë 18.07.2023, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidates, znj. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

6. Brenda afatit pesëditor, kandidatja, znj. {...}, depozitoi formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit 21 ditor (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ajo dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, në datën 14.07.2023 dhe 19.07.2023, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për në formimin fillestar në Shkollën e Magistraturës, ndër ta edhe për znj. {...}.

8. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

9. Gjatë procedurës së verifikimit, mbështetur në të dhënat e deklaruara nga vetë kandidatja në jetëshkrimin e depozituar në rastin e aplikimit pranë Shkollës së Magjistraturës, në lidhje me eksperiencën e saj në punë (punësimin) si dhe në ato të marra nga organet e sigurimeve shoqërore (me Shkresën nr. nr. 6311/1 prot., datë 24.07.2023 të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, protokolluar në Këshill me nr. 4205/1 prot., datë 25.07.2023), bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion nga subjektet që kanë mbikëqyrur disiplinën në punë të kandidatës znj. {...}, të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

10. Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/b dhe 149, pika 5 e Kushtetutës së Republikës, në nenin 276, pika 7 e Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit nr. 5, datë 20.12.2018 “Mbi caktimin me short të mandatit 3-vjeçar të anëtarëve gjyqtarë dhe anëtarëve jogjyqtarë”, të ndryshuar, si dhe në vendimin nr. 68, datë 25.07.2024 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 361 datë 29.07.2024, ka vendosur :

1. *Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Alban Toro.*
2. *Përfundimi i qëndrimit në detyrë të z. Alban Toro më datë 26.07.2024.*

10.1 Për shkak të mbarimit të mandatit të relatorit të çështjes z. Alban Toro, në Mbledhjen Plenare të datës 31.07.2024, relacioni “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar, për magjistrat, në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatës znj. {...}” u relatua nga anëtari zëvendësues i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Ilir Rusi.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KRITERET E PRANIMIT NË FORMIMIN FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

A. Për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat

11. Sa i përket kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përfshirë edhe për kandidaten {...}, si dhe më lart u parashtrua, vlerësimi për plotësimin e tyre është bërë, në momentin e kandidimit, nga ana e Shkollës së Magjistraturës, bazuar kjo në nenin 30¹ (“Kandidimi dhe vlerësimi paraprak i

¹ “1. Shkolla e Magjistraturës pranon aplikimet për pranimin në formimin fillestar, deri në fund të muajit shkurt të çdo viti. 2. Kandidatët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kriterëve të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kriterëve, nuk është i plotë, i saktë, ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, Shkolla e Magjistraturës mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga organet publike ose punëdhënësit e kandidatit. 3. Deri në datën 15 mars të çdo viti, Shkolla e Magjistraturës kryen një vlerësim paraprak, nëse kandidati përmbush kriteret e kandidimit, të parashikuara

kandidatëve”) të Ligjit të Statusit. Në përfundim të vlerësimit, Shkolla ka përgatitur dhe i ka paraqitur Këshillit të Lartë Gjyqësor raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat, ku pas komenteve të Këshillit, më datë 17.05.2023, Shkolla ka miratuar dhe publikuar në faqen e saj zyrtare Raportin e Vlerësimit Përfundimtar, përfshirë dhe listën e kandidatëve, të cilët plotësonin kriteret e parashikuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit. Në këtë listë është përfshirë dhe kandidatja {...}.

12. Gjithsesi, për kandidaten {...}, u konsiderua verifikimi sërish i disa prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përcaktuar në nenin 28 të Ligjit të Statusit.

12.1 Për këtë u mbajt në konsideratë diferenca kohore mes momentit të aplikimit të kandidatëve (Shkurt 2023), momentit të vlerësimit përfundimtar nga Shkolla e Magjistraturës për plotësimin e kriterëve nga ana e tyre (Prill 2023), si dhe momentit aktual, kur Këshilli duhet të shprehet për kualifikimin ose jo të kandidatëve për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, të cilët kanë rezultuar fitues në provimin e pranimit (Shtator 2023). Dhe po ashtu, nga ana tjetër, u mbajt në konsideratë dhe fakti se shumica e kriterëve të pranimit në formimin fillestar janë potencialisht të ndryshueshëm në kohë (me përjashtim të kriterit arsimor, kriterit të përvojës profesionale, kriterit të anëtarësisë në parti politike, në kohën e kandidimit dhe kriterit të anëtarësisë, bashkëpunëtorit ose të favorizuarit nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990).

12.2 Gjithashtu, për këtë u mbajt në konsideratë se një verifikim i tillë është detyrim ligjor për Këshillin e Lartë Gjyqësor që buron nga neni 32 (“Verifikimi i pasurisë dhe figurës”), pika 4/1², shkronja “ç”, të Ligjit të Statusit, sipas të cilit Këshilli ka detyrimin të verifikojë ekzistencën e çdo shkakut përjashtues (të parashikuar nga ligji) nga kandidimi për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Përveç kësaj, u mbajt në konsideratë detyrimi i Këshillit për verifikimin e kriterëve të zgjedhshmërisë, të cilat janë njëherazi edhe kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, pra ato sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit, është një detyrim konstant i Këshillit qoftë në momentin e emërimit të të diplomuarve për magjistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës, ashtu edhe gjatë karrierës së tyre si magjistrat (gjyqtar), referuar për këtë në nenet 35, 64 dhe 66 të Ligjit të Statusit.

në nenin 28 të këtij ligji. 4. Shkolla e Magjistraturës i paraqet Këshillave raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat. Këshillat mund të japin komente ose kundërshtime jo më vonë se në fund të muajit mars të çdo viti. Shkolla e Magjistraturës miraton raportin e vlerësimit përfundimtar, duke marrë në konsideratë komentet dhe kundërshtimet e bëra, dhe publikon raportin e vlerësimit përfundimtar në faqen e saj zyrtare, duke përfshirë listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 28 të këtij. 5. Çdo kandidat, i cili nuk është përfshirë në listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret, ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore të ankimit, të parashikuara në ligjin "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" dhe aktet nënligjore përkatëse".

² “4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës kur: ...; ç) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit”.

13. Konkretisht, për kandidaten u verifikua:

a) *zotësia e plotë për të vepruar*. Për kandidaten nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë;

b) *shtetësisë shqiptare*. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar dokumentin “Letërnjoftim”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 08.11.2021, në të cilin përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, pasqyrohet “shqiptare”, ndërkohë që gjatë verifikimit për kandidaten nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare. Gjithashtu, nga verifikimi i bërë, më datë 11.09.2023, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), sipas të dhënave elektronike vënë në dispozicion nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit, konstatohet se kandidatja vijon të ketë shtetësinë shqiptare;

c) *gjendja gjyqësore*. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës kandidatja ka depozituar dokumentin “*vërtetim i gjendjes gjyqësore*” e (Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve) duke printuar në letër Certifikatë Elektronike që mban datën 07.02.2023, ndërkohë që gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit të figurës së kandidates, u administrua Shkresa nr. 10342/1 prot., datë 09.08.2023, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore). Sipas këtyre dokumenteve, kandidatja nuk ka shënime në sistem;

ç) *disiplina në punë*. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës kandidatja ka depozituar dokumentin “librezë punë”, lëshuar më datë 09.05.2017, ndërkohë që gjatë verifikimit u administrua Shkresa nr. 4033/1 prot., datë 20.07.2023 e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Sipas këtij dokumenti kandidatja nuk ka masë disiplinore në fuqi;

d) *mosqenia bashkëpunëtore, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete*. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar një deklaratë datë 15.02.2023 në të cilën deklaron se nuk ka qenë bashkëpunëtore, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidates bashkëpunëtore, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete.

14. Për kriteret e tjera të pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës u konsiderua vlerësimi i bërë nga kjo e fundit dhe konkretisht për:

a) *pasjen e kriterit arsimor*. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar dokumentet: Diplomë Bachelor nr. {...} datë 15.03.2017 në degën Drejtësi e lëshuar nga Universiteti i Tiranës si dhe Certifikatë Notash datë 07.07.2016; Diplomë Master i Shkencave “E Drejtë Civile” nr.1705 datë 27.07.2017 si dhe Certifikatë Notash datë 21.04.2017 e lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë;

b) pasjen e përvojës profesionale. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës kandidatja ka depozituar dokumentin “Librezë pune”, sipas të cilit kandidatja, pas përfundimit të studimeve universitare në drejtësi, ka përvojë profesionale aktive në sektorin privat në profesionin “avokat” pranë zyrës avokatisë “Fatbardha {...}” për periudhën shtator 2017-korrik 2019, gjithashtu kandidatja ka përvojë profesionale aktive në sektorin publik, në profesionin “specialiste/ Shef Sektori/Drejtor”, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për periudhën gusht 2020 – qershor 2023;

c) mos anëtarësinë në parti politike në kohën e kandidimit. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar një deklaratë datë 15.02.2023, në të cilën deklaron se nuk është anëtare e ndonjë partie politike;

ç) mosqenien anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar një deklaratë datë 15.02.2023 në të cilën deklaron se nuk ka qenë anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, përveç se referuar moshës së saj (e datëlindjes 28.12.1988), ajo nuk mund të ketë qenë e tillë.

B. Për kriterin e pasurisë

15. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, sipas të cilës: “1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të pasurisë ...”.

16. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga institucionet publike kompetente të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit. Ky raportim u kërkua vetëm për kandidaten, në kushtet kur ajo nuk ka “person të lidhur” në kuptim të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar (nenet 3 dhe 5), si dhe Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (neni 2).

17. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 175/24 prot., datë 09.10.2023, protokolluar nw Këshill me nr. 4198/14 prot., datë 10.10.2023.

17.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidatja {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës pasurisë dhe interesave privatë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

17.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit është kryer kontrolli i plotë për pasuritë, asetet dhe interesat privatë të deklaruara nga kandidatja {...}, duke konkluduar se për kandidaten:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

17.3 Referuar rezultateve të kontrollit të plotë për pasuritë, asetet dhe interesat privatë dërguar nga ILDKPKI për kandidaten znj. {...}, relatori, më datë 13.10.2023 me anë të komunikimit elektronik “*Sqarim lidhur me verifikimin*” dhe në datë 19.10.2023 “*Re: Sqarim lidhur me verifikimin*” i parashtrori disa pyetje kandidates dhe iu dërgua “*Autorizimi për personin e lidhur*” në kuptim të neneve 3 dhe 5 të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, si dhe të nenit 2 të Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*” i ndryshuar, duke i i caktuar një afat 5 ditor për të paraqitur sqarimet dhe dokumentacionin pranë Këshillit.

17.3.1 Në përgjigje të këtyre pyetjeve znj. {...} më datë 20.10.2023, protokolluar në Këshill me aktin nr. 5494 prot., datë 20.10.2023, parashtrori sqarimet e saj dhe paraqiti dokumentacion shoqërues.

17.4 Në të njëjtën kohë me komunikimin elektronik me kandidaten, Relatori , me anë të shkresës nr.5351 prot., datë 13.10.2023 i është drejtuar ILDKPKI-së për informacion shtesë si dhe kopje të akteve në dosjen e kontrollit të plotë për pasuritë, asetet dhe interesat privatë të deklaruara nga kandidatja znj. {...}.

17.4.1 Me shkresën nr.3034/7 prot., datë 18.10.2023, protokolluar në Këshill me nr. 5351/1 prot., datë 19.10.2023, ILDKPKI përcolli informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar që lidhet me verifikimin e kandidates.

17.5 Pas verifikimit të informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga kandidatja si dhe nga e ILDKPKI-ja, Relatori, më datë 24.10.2023 me anë të komunikimit elektronik “*Vijim i komunikimit lidhur me sqarimet*” i parashtrori disa pyetje të tjera kandidates si dhe në vijim kërkoi : ...“*Gjithashtu në kushtet kur person i lidhur është ai sipas përcaktimeve të neneve 3 dhe 5 të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si dhe të nenit 2 të Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i*

ndryshuar, lutem depozitoni autorizimin e personit të lidhur “Prindërit” për vijimin e verifikimit dhe kontrollit të pasurisë së tyre nga ILDKPKI –ja në lidhje me vlerësimin e aftësisë dhe mjaftueshmerisë së burimeve financiare për shumen e dhuruar nga momenti i krijimit të tyre.”

17.5.1 Në përgjigje të këtyre pyetjeve, znj. {...}, më datë 09.11.2023, protokolluar në Këshill me aktin nr. 5850 prot., parashtrori sqarime dhe dokumentacion shoqërues.

17.6 Në vijim Relatori , me shkresën nr.5850/1 prot., datë 13.11.2023 i është drejtuar ILDKPKI-së për “Rishikim i analizës financiare të kandidatës për formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës znj. {...}” duke bashkëlidhur autorizimet (prindërit e saj) dhe dokumentacioni justifikues depozituar nga kandidatja.

17.6.1 Me shkresën kthim përgjigje nr.3034/16 prot., datë 30.11.2023, protokolluar në Këshill me nr. 5850/2 prot., datë 04.12.2023, ILDKPKI pas kryerjes së hetimit dhe procedurës së verifikimit të burimeve financiare sipas dokumentacionit të administruar ka sugjeruar “...Për sa më sipër, nëse nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor lindin paqartësi në procedurën e verifikimit të pasurisë, burimin e krijimit, lidhur me konstatimin dhe sqarimin e të dhënave që rezultojnë nga deklaratimet e kandidatit, gjetjet dhe përfundimet e ILDKPKI në zbatim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në Vendimin nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” mund të kërkohet thirrja e ekspertëve të fushës përkatëse.

17.6.2 Me anë të shkresës nr. 4198/46, datë 11.12.2023 “Mbi ushtrimin e kompetencave Kushtetuese nga Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave” drejtuar ILDKPKI, Relatori ka kërkuar nga kjo e fundit që të fokusohet në verifikimin e mundësisë financiare të personave të lidhur për të mbuluar me burime të ligjshme shumat e dhuruara, duke u përqendruar në përputhjen e periudhës kohore të të ardhurave dhe shpenzimeve të analizuar, numrit të personave të analizuar sipas periudhës së përbërjes familjare, përfshirjen në analizë të të gjitha shpenzimeve dhe investimeve të evidentuara deri në momentin e dhurimit të shumave përkatëse.

17.6.3 Me shkresën “kthim përgjigje”, nr. 3034/26 prot., datë 18.12.2023, protokolluar në Këshill me nr. 4198/54 prot., datë 20.12.2023, ILDKPKI, duke vlerësuar dhe analizuar në tërësi kërkesat e paraqitura me anë të shkresës nr. 4198/46 prot., datë 11.12.2023, konkludon: “...Në analizë të sa më sipër, në vijim të korrespondencës sonë, për aq sa pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ka lindur nevoja e verifikimit të mëtejshëm të pasurisë mbi konstatimin dhe sqarimin e të dhënave që rezultojnë nga deklaratimet e kandidatit, gjetjet dhe përfundimet e ILDKPKI në zbatim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në Vendimin nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për

emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” mund të kërkohet thirrja e ekspertëve të fushës përkatëse.

18. Me qëllim zgjidhjen e çështjeve lidhur me verifikimin e mundësisë financiare të personave të lidhur për të mbuluar me burime të ligjshme shumtë e dhuruara duke u përqendruar në përputhjen e periudhës kohore të të ardhurave dhe shpenzimeve të analizuar, numrit të personave të analizuar sipas periudhës së përbërjes familjare, përfshirjen në analizë të të gjitha shpenzimeve dhe investimeve të evidentuara deri në momentin e dhurimit të shumave përkatëse, për shkak të njohurive specifike të kërkua, pamundësisë për ta disponuar një të tillë nga organet ekzekutive, për për të bërë të mundur formatimin e propozimit për kandidaten në përputhje me pikën 17³, të Seksionit A, Kreu IX, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019, “*Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë*”, i ndryshuar, nga ana e Relatorit është kërkuar të caktohet një ekspert auditues kontabël.

19. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...} u kërkua informacion Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

19.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me Shkresën nr. 48815/1 prot., datë 22.08.2023, protokolluar në Këshill nr nr. 4486/3 prot., datë 25.08.2023, ku për kandidaten {...} rezultoi si e regjistruar si person fizik me Nipt L42202031S në sistemin tatimor më datë 02.10.2014, aktualisht ndodhet me status kërkesë për çregjistrim që prej datës 03.09.2015 si dhe pa detyrime të papaguara.

19.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 13003/1 prot., datë 18.08.2023, protokolluar në Këshill nr nr. 4487/1 prot., datë 21.08.2023 ku për kandidaten {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

20. Me shkresën nr. 5911 prot., datë 13.11.2023 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë Rajonale Fier, u kërkua informacion nëse nga ana e personit juridik “Denis” shpk me nr. NIPT {...} {...}, me administrator shtetasin {...} {...}, janë paguar detyrimet fiskale të tatimit mbi burim apo i mbajtur në burim nga të tretët.

20.1 Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, me anë të shkresës “kthim përgjigje” nr. 8639/1 prot., datë 20.11.2023, protokolluar në Këshill me nr. 5911/1 prot., datë 21.11.2023, ndër të tjera informon se: “*...Në sistemin tatimor DRT Fier, rezulton të jetë i regjistruar tatimpaguesi “DENIS/F” shpk, me NIPT {...}M, me administrator shtetasin {...} {...}{...}, me aktivitet “Aktivitete të mbrojtjes”, me adresë “Lagjia 1 Maji” Fier, me datrë regjistrimi në Administratën si NIPT datë 01.07.1996.*

³ Pika 17: Kur e vlerëson, Këshilli mund të thërrasë ekspertin për të dhënë shpjegime në mbledhjen e Këshillit. Në vendimin e arsyetuar të Këshillit për kualifikimin ose skualifikim e kandidimit, trajtohet edhe nevoja për ekspertim dhe mendimi i dhënë nga eksperti.

Shoqëria "DENIS/F" shpk sipas Vendimit të Gjykatës Nr.4067, datë 15.03.1994 dhe Nr.10034 datë 29.03.1995. Tatimpaguesi në sistemin tatimor, rezulton të ketë patur përgjegjësitë tatimore si vijon: - Tatim mbi vlerën e shtuar; -Tatim mbi fitimin. Tatimpaguesi rezulton të jetë ç' regjistruar nga përgjegjësitë tatimore në datë 07.03.2001. Situata e detyrimeve tatimore të palikujduara në sistemin tatimor në datë 17.11.2023 rezulton të jetë 0 lekë.

21. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, por edhe institucionet e tjera të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t'iu kërkuar kësaj të fundit bërja e një kontrolli dhe raportimi shtesë.

22. Në mbledhjen plenare të datës 31.07.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke patur në vëmendje praktikën e tij në raste analoge, me propozimin e relatorit z. Ilir Rusi, vendosi të mos vijojë me thirrjen/marrjen e ekspertit të fushës përkatëse, sa i përket verifikimit të mëtejshëm të pasurisë.

C. Për kriterin e figurës

23. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, sipas të cilës: *"1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të figurës"*.

24. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, u kërkuar raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

25. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidates {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e saj në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitetet të kundërligjshme.

26. Nga raportimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit, sipas shkresës nr. 866 prot., datë 01.08.2023, protokolluar në Këshill me nr. 4202/1 prot., datë 03.08.2023 nuk rezultoi ndonjë informacion i vlefshëm për qëllimet e verifikimit për kandidaten znj. {...}.

27. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, asaj iu kërkuar dhe plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 21.07.2023 formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të të dhënave të saj në lidhje me figurën dhe integritetin.

28. Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me Shkresën nr. 8395/1 prot., datë 04.10.2023, ka dërguar të dhënat për përbërësit e gjendjes civile edhe për kandidatën {...} pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile.

29. Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore) sipas shkronjës “c”, pika 12, e këtij relacioni, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, nuk konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidatja {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, duke konkluduar se kandidatja - *ka dorëzuar Formularin e Vetëdeklarimit me datë 21.07.2023;- formulari është regjistruar me numrin unik 000683;-vetëdeklarimi është publikuar në faqen zyrtare web të KLGJ-së;-në formular nuk ka deklaruar ndryshime;-Sektori i Gjendjes Civile, personi rezulton se (nuk ka ndryshime); -Sektori i Gjendjes Gjyqësore, personi rezulton (e padënuar) nga gjykatat penale shqiptare; - deri më sot nuk kemi pasur indicie apo të dhëna kryesish, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.*” Për pasojë, u vlerësua që nuk kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.

30. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatën {...}, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës në të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në Republikën e Shqipërisë, duke përcjellë në Këshill, me Shkresën nr. 1202/15 prot., datë 12.09.2023, protokolluar me aktin nr. 4200/1, datë 13.09.2023, përgjigjet zyrtare të 13 (trembëdhjetë) prokurorive. Gjithashtu, mbi kërkesën e Këshillit, u administrua dhe përgjigja e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, përcjellë me Shkresën nr. 10083/1 prot., datë 11.08.2023, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4201/1, datë 14.08.2023. Referuar përmbajtjes së informacioneve të administruara për kandidatën {...}, nuk rezulton që ndaj saj të jetë regjistruar kallëzim/referim/procedim penal, që ajo të ketë qenë ose të jetë nën hetim, që ndaj saj të jetë caktuar ndonjë masë sigurimi ose që ajo të jetë dënuar me vendim jo përfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë veprë penale.

31. Për verifikimin e figurës së kandidateve, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Gjykata e Lartë dhe të gjithë Gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm kanë kryer verifikimin përkatës, të cilat në kohë të ndryshme kanë përcjell pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor informacionin për kandidatët për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për znj. {...}. Sipas informacioneve të administruara, rezulton se “... znj. {...} nuk ka asnjë çështje të regjistruar apo vendim të dhënë në ngarkim të saj ...”

32. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të saj, pasur parasysh përcaktimet e shkronjave “b” dhe “c”, pika 4/1, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, sipas të cilave: “4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të .. figurës kur: ...; b) kandidati ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar; c) ka shfaqur sjellje të rënda të papërshtatshme etike dhe morale që cenojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë; ...”. Konkretisht, për kandidaten janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme në lidhje me:

- a) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidatja, të formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015;
- b) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidatja, të nënshkuara, të autorizimit për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e saj;
- c) ekzistencën ose jo të lidhjeve ose kontakte të papërshtatshme të kandidates me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar;
- ç) qenien ose jo të kandidates, anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- d) qenien ose jo të kandidates, bashkëpunëtore, informatore ose agjente e shërbimeve të inteligjencës.
- dh) ekzistencën ose jo të ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me sjelljen etike dhe morale të saj, mbi të cilën të ngrihen dyshime për cenim të besimit publik në sistemin gjyqësor dhe, për rrjedhojë, mbi pranueshmërinë ose jo të saj për në formimin fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës.

III. KONKLUZIONE

33. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, i ndryshuar, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

34. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja përmbush këto kriterë, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidates për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 32, pika 5, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, në nenin 86, shkronja “ë” dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...}, për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2023-2024.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR